



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

Nr. 1376 Prot.

Tiranë, më 15.04.2021

Lënda: Kërkohej nisja e hetimeve dhe verifikimeve mbi vjedhjen e identitetit dhe të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë

STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

MINISTRISË SË BRENDSHME

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE

Për dijeni:

OSBE/ODIHR

MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

AMBASADA E SHETETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

AMBASADËS BRITANIKE

KRYETARIT TË PARTISË DEMOKRATIKE

Z. LULZIM BASHA

Tiranë

Të nderuar Prokurorë,

Të nderuar drejtues dhe anëtarë të institucioneve shtetërore,

Siç dhe jeni në dijeni, në përmbushje të rolit dhe misionit të tij kushtetues, për mbrojtjen e parimeve, dhe të drejtave themelore të njeriut, të njohura nga Kushtetuta, si dhe me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të të gjithë aparatit shtetëror në tërësi, Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencave kushtetuese është angazhuar maksimalisht për të ndjekur edhe

me më shumë vëmendje, dhe për t'u informuar mbi çdo të dhënë që ka lidhje me funksionimin e institucioneve shtetërore, përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore, situatën para dhe paszgjedhore në tërësi.

Në kuadër të këtij monitorimi të nisur dhe nga disa të dhëna të publikuara në shtetin fqinj të Maqedonisë së Veriut, apo të atyre të siguruara, Presidenti i Republikës, është vënë në dijeni të disa fakteve, që lidhen me veprime të paligjshme që përbëjnë vepra penale, e që mund të kenë lidhje, të ndikojnë, apo të vënë në rrezik integritetin, apo vet rezultatin e zgjedhjeve në procesin zgjedhor që zhvillohet në datën 25 prill 2021.

Nga të dhënat e siguruara dhe atyre të bëra publike, rezulton se, në qarkun e Korçës, në disa bashki që janë të banuara nga komuniteti i pakicës kombëtare maqedonase, evidentohet se ka ndodhur një fenomen, ku shtetas me rekorde kriminale, të shpallur në kërkim ndërkombëtar, apo të përfshirë në veprimtari të paligjshme, janë pajisur me pasaportë dhe dokumente identifikimi nga autoritetet vendore atje, jo me të dhënat e tyre, por duke përdorur të dhënat e identitetit të personave të tjerë të cilët nuk kanë probleme me ligjin.

Në këtë mënyrë, këta persona, pas pajisjes nga shteti shqiptar me dokumente identifikimi, kanë vijuar më pas ndjekjen e procedurave edhe pranë shtetit të Maqedonisë së Veriut, nga ku për shkak të mbajtjes së dyshtetësisë së personit që i është vjedhur identiteti, janë pajisur edhe atje me dokumente identifikimi dhe kanë vijuar lëvizjen e lirë për t'iu fshehur autoriteteve të ndjekjes policore, apo të zbatimit të ligjit ndërkombëtar.

Siç rezulton të jetë bërë publike, Ministri i Brendshëm i Maqedonisë së Veriut, duke iu përgjigjur akuzave të opozitës atje, është shprehur se ka zbatuar ligjin në lëshimin e dokumenteve duke mos mbajtur përgjegjësinë për falsifikimin apo rrëmbimin e identitetit të shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë, përmes dokumenteve zyrtare të lëshuara po nga ana e institucioneve shqiptare.

Sipas asaj që është bërë publike, procedura e brendshme në shtetin fqinj të Maqedonisë së Veriut, për pajisje me pasaporta të shtetasve shqiptarë me kombësi maqedonase, të cilët janë të rregjistruar në qarkun e Korçës (Pustec) por edhe të Dibrës, orientohet të jetë e tillë:

- Ata pajisen me pasaportë nga shteti maqedonas vetëm pasi sjellin dokumentet origjinale, certifikatë lindjeje, certifikatë familjare dhe kartën e cila vërteton identitetin e tyre kombëtar të origjinës, vendndodhjen Pustec, Korçë, Dibër etj..
- Më pas këto dokumente përkthehen dhe legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke vijuar procesin e pajisjes me dokumente maqedonase.

Pra, shtetas të huaj dhe shqiptarë janë pajisur me dokumenta të gjendjes civile shqiptare duke vjedhur identitetin e shtetasve shqiptarë me kombësi maqedonase, pa dijeninë e këtyre të fundit.

Ky rrjet dhe kjo veprimtari e paligjshme është zbuluar në disa vende europiane. Çështja, që ka marrë përmasat e një skandali institucional, është bërë objekt debati publik në Maqedoninë e Veriut, dhe nga të dhënat e bëra publike nga autoritetet atje, duket qartë se origjina e këtij fenomenit rëndon edhe ndaj autoriteteve përgjegjëse në Shqipëri. Kjo pasi disa prej personave të identifikuar si pjesë e këtij rrjeti, të pajisur me dokumente të falsifikuara në shtetin fqinj, janë pajisur fillimisht me dokumente identifikimi shqiptare në bashkitë e sipërcituara.

Përsa më sipër, në këtë skandal mund të jenë përfshirë Bashkia Korçë, Bashkia Pustec, dhe zyrat përkatëse të gjendjes civile apo të prodhimit të dokumenteve të identifikimit, por pa u përjashtuar përfshirja e punonjësve apo individëve brenda institucioneve të tjera si, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyra e legalizimeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme, organizata jo fitimprurëse që veprimtarinë e tyre e lidhin me fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së pakicave kombëtare.

Nga krahasimi i të dhënave që kemi administruar, apo që janë bërë publike, nëse fakte të tilla rezultojnë të vërteta, mund të jemi përpara një fenomeni masiv, ku për qëllime përfitimi ekonomik, apo të natyrave të tjera, numri i këtyre rasteve mund të jetë i lartë.

Nisur nga situata e krijuar, **dhe faktit se krimi zgjedhor në Shqipëri është një fenomen që ka bashkëpunëtorë dhe autor të niveleve të larta**, si President i Republikës, kam shqetësimin se, veprimi kriminal i vjedhjes së identitetit të një shtetasi shqiptar, mund të jetë shndërruar edhe në një mekanizëm lehtësisht të shfrytëzueshëm nga elementë kriminalë këtu në Shqipëri, **me qëllim ndërhyrjeje në procesin zgjedhor, përmes votimit të një personi disa herë, me mjete të ndryshme identifikimi të marra në këtë mënyrë.**

Të dhënat e publikuara, jo vetëm që evidentojnë një **veprimtari të paligjshme, të konsumuar në formë të organizuar dhe në bashkëpunim**, por nga ana tjetër, **cenojnë rëndë integritetin dhe sigurinë e procesit të pajisjes me dokumente identifikimi nga Republika e Shqipërisë**, duke hedhur idenë në publik, se në Shqipëri, çdokush mund të pajiset me dokument identifikimi e të lëvizë lirisht, pavarësisht se është në ndjekje apo në kërkim ndërkombëtar.

Kjo është një arsye më shumë, për nevojën që paraqet hetimi i menjëhershëm i këtij fenomeni.

Jo vetëm kaq, po nëse ky fenomen ka ndodhur në masë, kjo çështje mund të përdoret jo vetëm për qëllime nga më të ndryshme kriminale, por edhe për shtrembërimin e votës së votuesve

realë, duke votuar në emër të tyre, apo në emër të emigrantëve që nuk kanë mundësinë të vijnë në atdhe për të ushtruar të drejtën e votës.

Është e vërtetë se implementimi i identifikimit biometrik në procesin zgjedhor, krijon një barrierë mbrojtëse në këtë drejtim. Por askush nuk mund të jetë i sigurtë mbi procesin e mekanizmit kriminal dhe hollësitë e mënyrës se si mund të jenë manipuluar të dhënat biometrike, të regjistruara në pasaporta apo ID të lëshuara me të dhëna të rreme.

Ndaj e gjithë kjo çështje, nga sa është bërë publike dhe informohemi, është shumë shqetësuese, dhe përmban elementë të disa veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal:

- Veprimet që lehtësojnë trafikimin, Neni 110/c i Kodit Penal;
- Falsifikimi i dokumenteve, Neni 186 i Kodit Penal;
- Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave, neni 189 i Kodit Penal;
- Falsifikimi i akteve të gjendjes civile, Neni 191 i Kodit Penal;
- Shpërdorimi i detyrës, Neni 248 i Kodit Penal;
- Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve, Neni 298 i Kodit Penal.

Ndërkohë që, dokumentet e identifikimit të falsifikuara përmes këtij mekanizmi, mund të përdoren në këto Bashki nga personat përfitues, sidomos për të favorizuar një forcë politike të caktuar, dhe duke konsumuar kështu elementët e veprës penale të votimit më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 327/a , paragrafi i parë, i Kodit Penal, që sanksionon se:

“Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”

Si President i Republikës, jam shumë i shqetësuar nga ky skandal i denocuar tashmë publikisht në shtetin fqinj e që përfshin dhe Republikën e Shqipërisë.

Me qëllim zbardhjen e së vërtetës, ushtrimin e ndjekjes penale, verifikimin se deri në çfarë mase ky fenomen ka prekur të dhënat e shtetasve shqiptarë, si dhe me qëllim parandalimin e kryerjes së çdo veprimi të paligjshëm në këtë proces zgjedhor, **i kërkoj organit të Prokurorisë dhe organeve të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të nisin menjëherë hetimet dhe verifikimet përkatëse, duke marrë pa vonesë masat e nevojshme për të siguruar më shumë të dhëna e prova për këtë veprimtari të paligjshme, por edhe për të ruajtur të pacenuar integritetin e procesit zgjedhor.**

Vlerësoj se, në një situatë të tillë, nisja e hetimeve dhe verifikimeve është një detyrë për çdo funksionar publik, të Prokurorisë apo organizmave të tjerë përgjegjës të shtetit, pasi së pari

duhet parandaluar çdo veprimtari që cenon të drejtën për zgjedhje të lira e të ndershme, dhe njëkohësisht hetimi penal do duhet të vendosë përpara përgjegjësisë autorët e veprave penale, ashtu siç duhen marrë masa edhe për bllokimin dhe shkatërrimin e dokumenteve të falsifikuara.

Në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj shkrese, po ju përcjell disa të dhëna që do t`ju ndihmojnë në fillimin e verifikimeve tuaja, si dhe kopje të të dhënave për disa prej shtetasve të pajisur me dokumente të falsifikuar me identitet të vjedhur (shqiptaro-maqedonas), për të cilët është bërë denoncimi publik në shtetin e Maqedonisë së Veriut.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Iir META

Shtojca 1:

Disa prej artikujve lidhur me këtë skandal gjenden të publikuar në këto *websit-e*:

- <https://balkaninsight.com/2021/04/06/north-macedonia-arrests-police-in-crackdown-on-passport-forgers/>
- <https://zhurnal.mk/editorial-me-ndihmen-e-nderkombetareve-te-zbulohen-pergjegjesit-e-pasaportave-false/>
- <https://www.euronews.com/2021/04/07/north-macedonia-officials-handed-fake-passports-to-overseas-criminals-claims-interior-mini>
- <https://shqip.republika.mk/lideri-shqiptar-i-kartelit-te-droges-dhe-i-dyshuari-per-vrasje-ne-tentative-ne-ukraine-pjese-e-personave-qe-moren-nje-pasaporte-maqedonase-nga-ministria-e-brendshme/>
- <https://www.ctpost.com/news/amp/North-Macedonia-crime-ring-sold-passports-to-16081077.php>
- <https://abcnews.go.com/amp/International/wireStory/north-macedonia-crime-ring-sold-passports-criminals-76906145>
- https://www.washingtonpost.com/national/north-macedonia-crime-ring-sold-passports-to-criminals/2021/04/06/76f5ad1a-9710-11eb-8f0a-384cf4fb399_story.html?outputType=amp